

TË DHËNAT ADMINISTRATIVE TË TREGUT TË PUNËS

Metadata Referenciale në format Euro SDMX Metadata Structure
(ESMS)

INSTAT

Metadata Referenciale

1. Kontakt.....	2
2. Përditësimi i metadatave	2
3. Paraqitura statistikore.....	2
4. Njësia matëse	4
5. Periudha e referencës	4
6. Mandati institucional.....	4
7. Konfidencialiteti	4
8. Politika e botimit.....	5
9. Shpeshtësia e shpërndarjes.....	5
10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia	5
11. Manaxhimi i cilësisë	6
12. Rëndësia	7
13. Saktësia dhe besueshmëria.....	7
14. Afatet kohore dhe përpikmëria	8
15. Koheranca dhe Krahasueshmëria.....	8
16. Kostoja dhe ngarkesa	9
17. Rishikimi i të dhënave.....	9
18. Përpunimi statistikor	9
19. Komente	10
Aneks	10

1. Kontakt	
1.1. Institucioni i kontaktit	INSTAT, Instituti i Statistikave
1.2. Njësia e kontaktit	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës, Drejtoria e Statistikave të Sektorit Real
1.3. Personi i kontaktit	Julinda Hackaj
1.4. Funksioni i personit të kontaktit	Specialist, Sektori i Statistikave të Tregut të Punës
1.5. Adresa postare	Rr. Vllazën Huta, Ndërtesa 35, Hyrja 1, Tiranë, Kodi Postar 1017
1.6. Adresa elektronike (e-mail)	jhackaj@instat.gov.al
1.7. Numri i telefonit	+(355) 4 2222411 / +(355) 4 2233356
1.8. Numri i faksit	+355 4 2228300
2. Përditësimi i metadatave	
2.1. Çertifikimi i fundit i metadatës	24.07.2023
2.2. Publikimi i fundit i metadatës	24.07.2023
2.3. Përditësimi i fundit i metadatës	24.07.2023
3. Paraqitja statistikore	
3.1. Përshkrimi i të dhënave	<p>Të dhënat Administrative mbi Tregun e Punës përbajnë të dhëna mbi punësimin, papunësinë dhe forcën e punës.</p> <p>Objektivi kryesor i statistikave Administrativë të Tregut të Punës është paraqitja e situatës korrente lidhur me punësimin (vendet e punës), papunësinë e regjistruar si dhe përmbrushja e objektivave parashikuar në Programin e Statistikave Zyrtare.</p>
3.2. Sistemi i klasifikimit	<p>Për klasifikimin dhe kodifikimin e statistikave të Tregut të Punës përdoren:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Për profesionet ISCO 08 • Për aktivitetet Ekonomike NVE Rev.2
3.3. Mbulimi i sektorit	<p>Ky informacion mbulon të dhëna mbi:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. bilancin e forcave të punës;

	<p>2. punëkërkuesit e papunë të regjistruar sipas gjinisë dhe nivelit arsimor;</p> <p>3. të punësuarit në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve;</p> <p>4. punësimit sipas burimeve administrative dhe sektori bujqësor;</p> <p>5. punë kërkuesve të papunë të regjistruar.</p>
3.4. Koncepte statistikore dhe përkufizime	<p>Punësimi në sektorin shtetëror përbëhet nga të gjithë të punësuarit në qeverinë qendrore, pushtetin vendor dhe ndërmarrjet publike buxhetore dhe jobuxhetore.</p> <p>Punësimi në sektorin privat jo-bujqësor përbëhet nga të gjithë personat në moshë pune që kanë një punë si të punësuar me pagë ose si të vetëpunësuar të deklaruar në Drejtori të Përgjithshme të Tatimeve.</p> <p>Papunësia e regjistruar përbëhet nga të gjithë personat që regjistrohen në zyrat e punësimit në bazë të VKM Nr. 70, datë 11.02.1999 "Për evidentimin e punëkërkuesve të papunë".</p> <p>Sipas këtij ligji, "punëkërkues", është çdo person i papunë, i disponueshëm për punësim, i cili paraqitet periodikisht në zyrën përkatëse të punësimit. Të tillë konsiderohen dhe personat të cilët janë në marrëdhënie pune ose të vetëpunësuar, por që kërkojnë një punë të re. Punëkërkuesi është një person, i cili:</p> <ul style="list-style-type: none"> a. Jeton në Shqipëri b. Është mbi 16 vjeç c. Paraqitet personalisht në Zyrën e Punësimit për të gjetur punë d. Është i aftë për punë
3.5. Njësia statistikore	Njësia statistikore e të dhënavë Administrative të Tregut të Punës janë të punësuarit në sektorin privat jobujqësor, të punësuarit në sektorin shtetëror, të punësuarit në sektorin privat bujqësor, papunësia e regjistruar.
3.6. Popullata statistikore	Popullata statistikore i referohet popullsisë që përfiton shërbimet: forcës së punës; punëkërkuesve të papunë të regjistruar sipas gjinisë dhe nivelit arsimor; ligjvënës, nëpunës të lartë dhe drejtuese; specialistë, teknikë dhe ndihmës specialistë; nëpunës të thjeshtë; punëtorë; të punësuar në sektorin shtetëror; të punësuar në sektorin privat jo-bujqësor; të punësuar në sektorin bujqësor; punëkërkues të papunë të regjistruar për herë të parë në zyrat e punës; punëkërkues të papunë të regjistruar me aftësi të kufizuar; punëkërkues të papunë të regjistruar romë dhe egjiptianë; përfitues të pagesës së papunësisë së regjistruar; punëkërkues të papunë të regjistruar në ndihmë ekonomike.
3.7. Zona e referencës	Statistikat Administrative të Tregut të Punës mbulojnë të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.
3.8. Mbulimi në kohë	<p>Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2000 dhe në vazhdim për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Të dhënat lidhur me statistikat Administrative të Tregut të Punës për bilancin e forcave të punës, • Punëkërkuesit e papunë të regjistruar sipas gjinisë dhe nivelit arsimor, • Të punësuarit në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, <p>Të dhënat janë të disponueshme nga viti 2000 dhe në vazhdim për:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Punësimit sipas burimeve administrative dhe sektori bujqësor • Punëkërkuesve të papunë të regjistruar.

3.9. Periudha bazë	Nuk aplikohet.
4. Njësia matëse	Në statistikat e Tregut të Punës njësia matëse është në numër, përqindje dhe lekë.
5. Periudha e referencës	Periudha e references për të dhënët Administartive të Tregut të Punës është 31 Dhjetor 2022. Ky raport i referohet vitit 2022.
6. Mandati institucional	
6.1. Akte ligjore dhe marrëveshje të tjera	<p>➢ Baza ligjore në nivel kombëtar për prodhimin e statistikave Administrative të Tregut të Punës:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare" • Programi Kombëtar i Statistikave Zyrtare 2022-2026 • Memorandum i bashkëpunimit i hartuar me institucionet e tjera.
6.2. Shkëmbimi i të dhënavë	Statistikat administrative të tregut të punës nuk transmetohen në EUROSTAT. Aktualisht, INSTAT plotëson një sërë pyetësorësh të organizmave ndërkombëtare në lidhje me punësimin dhe papunësinë e regjistruar, të tillë si: EUROSTAT, ILO, etj.
7. Konfidencialiteti	
7.1. Konfidencialiteti - politika	Të dhënat e mbledhura konsiderohen rreptësisht konfidenciale dhe përdoren vetëm për qëllime statistikore e kërkime shkencore në përputhje me Ligji Nr. 17/2018 "PËR STATISTIKAT ZYRTARE", si dhe Ligji Nr. 9887, datë 10.03.2008 "Mbrojtja e të Dhënavë Personale". Neni 31 i ligjit për statistikat zyrtare përcakton qartë që i gjithë informacioni statistikor i mbledhur nga INSTAT është konfidencial dhe mund të përdoret ose botohet vetëm në tabelë përbledhëse të tillë që nuk identifikojnë njësinë burim të informacionit. Identifikim i drejtpërdrejtë quhet kur një njësi statistikore identifikohet drejtpërdrejt nga emri, adresa ose ndonjë numër identifikimi i njohur zyrtarisht. Kur përpunimi i të dhënavë kryhet në mënyrë të tillë që mundëson identifikimin e subjektit të të dhënavë, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektit të mos janë më të identifikueshëm.
7.2. Konfidencialiteti - trajtimi i të dhënavë	<p>INSTAT mbron dhe nuk shpërndan të dhënat që ka mbledhur ose që ka akses, të cilat mundësojnë identifikimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë të njësive statistikore. INSTAT ndërmerr të gjitha masat e duhura për të parandaluar dhe bërë të pamundur identifikimin e njësive statistikore përmes mjeteve teknike të tjera që mund të përdoren nga palët e treta. Të dhënat statistikore që mund të bëjnë të mundur identifikimin e njësisë statistikore, shpërndahen nga INSTAT vetëm në rast se:</p> <p>a) Këto të dhëna janë trajtuar, siç është përcaktuar në mënyrë të veçantë në Rregullore, këto të dhëna janë trajtuar në mënyrë të atillë, sa nuk krijon paragjykim në lidhje me konfidencialitetin statistikor ose</p> <p>b) Njësia statistikore ka dhënë miratimin përkatës për bërjen publike të të dhënavë. Të dhënat konfidenciale i përcillen INSTAT-it vetëm për qëllime</p>

	<p>statistikore dhe vetëm personat që kanë të drejtë aksesi tek to dhe ato të ngarkuar të punojnë me to.</p> <p>Çështjet dhe problemet në lidhje me ruajtjen e konfidencialitetit statistikor verifikohen dhe trajtohen nga stafi i INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi, janë të përcaktojë shkallën e detajeve që mund të shpërndahet dhe të bëhet publike nga INSTAT. Përgjegjësitë e këtij stafi janë të rekomandojë se: në cilin nivel detajimi mund të shpërndahen të dhënat statistikore, në mënyrë që identifikimi i drejtpërdrejtë ose indirekt, i njësisë statistikore të vrojtuar të mos jetë i mundur; kriteret e anonimizimit për mikrodatat që u janë dhënë përdoruesve; dhënia e hyrjes për kërkuesit në të dhëna konfidenciale për qëllime shkencore. Të dhënat e publikuara janë në nivel të përgjithshëm, nuk publikohen të dhëna individuale.</p>
--	---

8. Politika e botimit

8.1. Kalendari i publikimeve	Njoftimet në lidhje me shpërndarjen e statistikave janë botuar në kalendarin e publikimit, i cili është në dispozicion në faqen e internetit. Njoftime dhe vonesat janë para-njoftuar në këtë kalendarin. Në rastin e vonesave specifikohet data e publikimit të ardhshëm si dhe shpjegimi lidhur me arsyet e vonesave.
8.2. Aksesi në kalendarin e publikimeve	Kalendari i publikimeve mund të aksesohet online në faqen e internetit të INSTAT.
8.3. Aksesi i përdoruesve	<p>Në përputhje me nenin 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrtare", statistikat zyrtare shpërndahan në mënyrë që të gjithë përdoruesit të kenë të drejtë të menjëhershme dhe të barabartë dhe përdoren të gjitha format e mundshme të medias. INSTAT-i dhe agjencitë statistikore, duke pasur në program përgjegjësitë për shpërndarjen, kërkojnë të përbushin çdo kërkesë të çdo organizate ose individi, për të dhëna të pabotuara ose analiza të veçanta. Kanalet nga të cilat përdoruesit mund të marrin rezultatet e publikimit janë si më poshtë:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Website – online release; 2. Kërkesat e shkruara; 3. Publikimi; 4. Seksioni Kërkesa të dhënash.
9. Shpeshtësia e shpërndarjes	Të dhënat Administrative të Tregut të Punës janë publikuar në faqen e Web-it të INSTAT me një periodicitet tremujor dhe vjetore.

10. Aksesi në të dhëna dhe qartësia

10.1. Njoftim për media	Njoftim për media përmban informacion në lidhje me treguesit kryesorë të Statistikave Administrative të Tregut të Punës si: punësimi në sektorin shtetëror, punësimi në sektorin privat jo-bujqësor, papunësia e regjistruar etj. Njoftimi për shtyp i Statistikave Administrative të Tregut të Punës publikohet online në faqen e internetit të INSTAT.
10.2. Publikime	Rezultatet për Statistikat Administrative të Tregut të Punës gjenden të botuara në botimet: "Të Dhënat Administrative të Tregut të Punës", "Tregu i Punës",

	<p>“Vjetari Statistikor” dhe “Vjetari Statistikor Rajonal”.</p> <ul style="list-style-type: none"> • "Të Dhënat Administrative të Tregut të Punës" • "Tregu i Punës" • "Vjetari Statistikor" • "Vjetari Rajonal Statistikor" <p>Përdoruesit mund t’i gjejnë rezultatet në faqen e internetit të INSTAT.</p>
10.3. Baza e të dhënavë on-line	Të dhënat për Statistikat Administrative të Tregut të Punës janë të publikuara në faqen zyrtare të INSTAT, seksioni Databaza Statistikore
10.4. Aksesi në të dhënat mikro	Të dhënat për Statistikat e Tregut të Punës nuk bëhen të disponueshme në nivel mikro, si pasojë e ruajtjes së konfidencialitetit. Të dhënat e agreguara, janë lloji i vetëm i të dhënavë që ofrohet për përdoruesit e jashtëm. Edhe pse të dhënat mikro nuk publikohen, ato mund të aksesohen në bazë të nenit 34 të Ligjit Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrta".
10.5. Të tjera	Përdoruesit mund të dërgojnë kërkesa të tjera specifike nëpërmjet një sesioni të dedikuar për kontaktet në linku më poshtë: Kontakt .
10.6. Dokumentimi i metodologjisë	Një shpjegim i shkurtër lidhur me përkufizimet, konceptet kryesore dhe shpjegimet metodologjike për përdoruesit publikohet në njoftimin për shtyp dhe publikimet. Informacione shtesë u jepen përdoruesve të brendshëm kur është e nevojshme. Në faqen e INSTAT ka një seksion lidhur me Metodologjinë mbi Statistikat Administrative të Tregut të Punës.
10.7. Dokumentimi i cilësisë	Sektori i Statistikave të Tregut të Punës dokumenton të gjithë procesin e punës dhe procedurat mbi Të Dhënët Administrative të Tregut të Punës për qëllime të brendshme.
11. Manaxhimi i cilësisë	
11.1. Sigurimi i cilësisë	INSTAT është i angazhuar për sigurimin e cilësisë në prodhimin e statistikave zyrtare. Duke u bazuar në Ligji Nr. 17/2018 "Për Statistikat Zyrta", INSTAT përdor metoda dhe procese statistikore në përputhje me parimet dhe standarde shkencore të pranuara ndërkombëtarisht, si dhe kryen analiza të vazhdueshme, me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe ofrimin e statistikave të përditësuara. Në kryerjen e detyrave të tij, INSTAT ndjek parimet e përgjithshme të menaxhimit të cilësisë, në përputhje me Kodin e Praktikës së Statistikave Evropiane (European Statistics Code of Practice). INSTAT për sigurimin e cilësisë udhëhiqet nga parimet e mëposhtme: paanshmëria, cilësia e proceseve dhe produkteve statistikore, orientimi për përdoruesit, orientimi për punonjësit, efektiviteti i proceseve statistikore dhe reduktimi i ngarkesës së të intervistuarve.
11.2. Vlerësimi i cilësisë	Burimi i të dhënavë për Statistikat e Tregut të Punës është administrativ. Të dhënat krahasohen me të dhënat e viteve të mëparshme për të dalluar nëse ka koherencë të dhënash apo ka pasur ndryshime të mëdha.

12. Rëndësia

12.1. Nevojat e përdoruesit	<p>Përdoruesit e Statistikave të Tregut të Punës klasifikohen si të jashtëm dhe të brendshëm.</p> <p>➤ Përdoruesit e jashtëm janë:</p> <ul style="list-style-type: none">• Institucionet e Administratës Publike;• Universitetet;• Bizneset;• Publiku i përgjithshëm dhe grupet e tjera të interesit;• Organizata kombëtare jo fitmprurëse; <p>➤ Përdoruesit e brendshëm janë drejtoritë prodhuuese të INSTAT të cilat përdorin Statistikat e Tregut të Punës si input për punën e tyre.</p>
12.2. Kënaqësia e përdoruesit	<p>Klikimet (Page Views) në lidhje me Të dhënat Administrative të Tregut të Punës për vitin 2022 janë rreth 36.748 klikime.</p> <p>INSTAT, ka kryer vrojtimin për matjen e kënaqësisë së përdoruesve. Pyetjes: Si e vlerësoni cilësinë e përgjithshme të "Të dhënavë Administrative të Tregut të Punës"? në shkallën nga 1 (shumë e dobët) tek 5 (shumë e mirë), përdoruesit kanë vlerësuar cilësinë e të dhënavë me një mesatare prej 3,33 (66.6%).</p> <p>INSTAT organizon çdo vit Anketën e Kënaqësisë së Përdoruesve.</p>
12.3. Plotshmëria	<p>Plotshmëria e të dhënavë për Statistikat e Tregut të Punës për vitin 2022 gjykohet duke krahasuar cilësinë dhe sasinë e treguesve të mbuluar në INSTAT nga ato të Programit Kombëtar të Statistikave Zyrtare 2022-2026. Shkalla e Plotshmërisë të Statistikave të Tregut të Punës për 2022 është 100%.</p>
<h2>13. Saktësia dhe besueshmëria</h2>	
13.1. Saktësia e përgjithshme	<p>Në përgjithësi, të dhënat janë kontrolluar me vitet e mëparshme për të identifikuar ndonjë ndryshim të rëndësishme në ecurinë e të dhënavë. Në rastet kur hasen ndryshime, INSTAT njofton burimet përkatëse të të dhënavë për të vënë në dijeni rreth gjetjeve të konstatuara në mënyrë që të realizohet korrigimi i këtyre të dhënavë nëse shihet i nevojshëm ose të konfirmohen në mënyrë zyrtare.</p>
13.2. Gabim i kampionimit	<p>Nuk aplikohet.</p>
13.3. Gabim jo i kampionimit	<p>Rishikimi i të dhënavë ndodh vetëm në rast se institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT për efekt përditësimi apo ndonjë gabimi të mundshëm human. Nëse institucionet përkatëse rishikojnë të dhënat e dërguara në INSTAT, atëherë në publikimin më të afërt do të pasqyrohen këto ndryshime dhe do të jepet një informacion i shkurtër sqarues për përdoruesit. Gabimet e jokampionimit trajtohen bazuar në politikën e Trajimit të Gabimeve.</p>

14. Afatet kohore dhe përpikmëria

14.1. Afatet kohore	<p>Rezultatet e Statistikave të Tregut të Punës publikohen në faqen e internetit të INSTAT 205 ditë pas përfundimit të periudhës referuese ($T + 205$ ditë). Periudha referuese e rezultateve të Statistikave të Tregut të Punës është data 31 Dhjetor 2022.</p> <table border="1"> <tr> <td>Periudha referuese</td><td>12/31/2022</td></tr> <tr> <td>Data e publikimit</td><td>07/24/2023</td></tr> <tr> <td>Afatet kohore</td><td>205</td></tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e publikimit	07/24/2023	Afatet kohore	205		
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e publikimit	07/24/2023								
Afatet kohore	205								
14.2. Përpikmëria	<p>Të dhënat të tregut administrative të punës publikohen bazuar në kalendarin e publikimeve. Publikimi i Të dhënat administrative të tregut të punës ka qënë i përpiktë në kohë në 100 % të publikimeve të kryera gjatë viteve.</p> <table border="1" data-bbox="425 658 890 819"> <tr> <td>Periudha referuese</td> <td>12/31/2022</td> </tr> <tr> <td>Data e shpallur</td> <td>07/24/2023</td> </tr> <tr> <td>Data e publikimit</td> <td>07/24/2023</td> </tr> <tr> <td>Vonesa në kohë</td> <td>0</td> </tr> </table>	Periudha referuese	12/31/2022	Data e shpallur	07/24/2023	Data e publikimit	07/24/2023	Vonesa në kohë	0
Periudha referuese	12/31/2022								
Data e shpallur	07/24/2023								
Data e publikimit	07/24/2023								
Vonesa në kohë	0								

15. Koheranca dhe Krahasueshmëria

15.1. Krahasueshmëria gjeografike	<p>Statistikat e Tregut të Punës paraqiten në nivel vendi. Këto statistika janë relativisht të krahasueshme pasi institucionet që na sigurojnë të dhënat koordinojnë procesin e mbledhjes së të dhënavëve.</p>
15.2. Krahasueshmëria kohore	<p>Statistikat e Tregut të Punës në lidhje me: statistikat Administrative të Tregut të Punës për bilancin e forcave të punës, punëkërkuesit e papunë të regjistruar sipas gjinisë dhe nivelit arsimor, të punësuarit në sektorin shtetëror sipas grupeve kryesore të profesioneve, datojnë që nga viti 2000 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 23 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=23$). Statistikat e Tregut të Punës në lidhje me: punësimin sipas burimeve administrative dhe sektori bujqësor, punëkërkuesit e papunë të regjistruar datojnë që nga viti 2000 referuar databazës statistikore duke siguruar një krahasueshmëri kohore prej 23 vitesh ($CC2=Jlast-Jfirst+1=23$). Të dhënavë ju bëhen kontolle të vazhdueshme për të garantuar krahasueshmërinë e tyre në seri kohore.</p>
15.3. Koheranca e ndërthurjes së fushave	<p>Nuk aplikohet.</p>
15.4. Koheranca e brendshme	<p>Konsistenca e brendshme e të dhënavëve kontrollohen para se të finalizohen. Kontrollohen gjithashtu lidhjet midis variablate dhe koheranca në seri të ndryshme.</p>

16. Kostoja dhe ngarkesa	Stafi i përfshirë në përgatitjen e statistikave të tregut të punës pranë Sektorit të Statistikave të Tregut të Punës është: 1 punonjës pranë zyrave qëndrore të INSTAT, pasi të dhënat e statistikave të tregut të punës sigurohen nga burime administrative në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe Shërbimit Kombëtar të Punësimit.
17. Rishikimi i të dhënave	
17.1. Politika e rishikimit	Politikat e rishikimit bëhen në përputhje me politikën e rishikimit si dhe politikën e trajtimit të gabimeve të vendosura nga INSTAT. Për më shumë referohuni: <ul style="list-style-type: none"> • <u>Politika e revizionimit</u> • <u>Politika e trajtimit të gabimeve</u>
17.2. Praktika e rishikimit	<p>Në rast burimet të cilat dërgojnë pranë INSTAT të dhënat mbi Statistikat e Tregut të Punës do të raportojnë ndryshime në tabelat e dërguara, ky informacion do të përditësohet dhe publikohet në publikimin e radhës, shoqëruar me një shënim shpjegues për përdoruesit.</p> <p>Nuk janë kryer rishikime mbi “Të dhënat Administrative të Tregut të Punës” për vitin 2022, subjekt i këtij raporti.</p>
18. Përpunimi statistikor	
18.1. Burimi i të dhënave	Informacioni mbi Statistikat e Tregut të Punës grumbullohet nga burimet administrative në kuadër të Memorandumeve të bashkëpunimit, përkatësisht me: <ul style="list-style-type: none"> • DPT, për të gjithë individët e regjistruar në formularin e Listëpagesës; • SHKP, për të gjithë personat e regjistuar si punëkërkues të papunë;
18.2. Shpeshtësia e grumbullimit të të dhënave	Të dhënat e Statistikave të Tregut të Punës grumbullohen prej burimeve administrative në baza tremujore dhe vjetore, me detajime mujore.
18.3. Grumbullimi i të dhënave	Instituti i Statistikave organizon punën për llogaritjen e indikatorëve dhe statistikave të Tregut të Punës për vitin 2022, e orientuar nga Programi i Statistikave Zyrtare dhe Ligji i Statistikës. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Zyrat Statistikore Rajonale dhe Shërbimi Kombëtar i Punësimit janë burimi kryesor i të dhënave për të gjitha treguesit që publikohen sipas këtij programi.
18.4. Vlefshmëria e të dhënave	Të dhënavë u janë bërë kontolle logjike dhe matematike. Këto kontolle kryhen gjatë të gjithë procesit të përpunimit të të dhënave, për të gjithë treguesit të cilët INSTAT publikon. Ndër metodat e verifikimit të dhënave administrative mund të përmendim: Kontrolli për plotësinë e të dhënave, konsistенca me kalimin e kohës, korrigimet aritmëtike (nuk duhet të janë shumë të larta), kontrolllet përbledhëse, kontrolli i serive kohore nëse ka devijime të mëdha, etj.
18.5. Përpilimi i të dhënave	Nuk aplikohet.

18.6. Rregullimi	Nuk aplikohet.
19. Komenti	
Aneks	